



FORCAT E ARMATOSURA

Një mundësi për të rinjtë që kërkojnë sfidë, profesion dhe shërbim ndaj vendit

» faqe 3



SHQIPËRIA DHE USEUCOM FORCOJNË PARTNERITETIN NË FUSHËN E MBROJTJES

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me gjeneral brigade Chris McKinney, zëvendësrektor i Drejtorisë për Planifikim, Politika, Strategji dhe Kapacitete në Komandën Amerikane për Evropën (USEUCOM). Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet më të fundit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe mbi situatën e sigurisë në rajon dhe më gjerë. Bashkëbiseduesit vlerësuan nivelin e lartë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të USEUCOM-it në rritjen e kapaciteteve...

faqe 3



PRANVERA SKANA EMËROHET ZYRTARISHT ZËVENDËSMINISTRE E MBROJTJES

Pranvera Skana, një profil profesional në shërbim të komunikimit dhe sigurisë. Emërimi i znj. Pranvera Skana në detyrën e zëvendësministres së Mbrojtjes shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e dimensionit të komunikimit strategjik në institucionet e sigurisë në vend. Me një profil të konsoliduar në fushën e medias, diplomacisë dhe akademisë, ajo sjell në këtë detyrë një kombinim të vyer përvojë dhe ekspertize. E lindur në Rrëshen të Mirditës, Skana ka ndërtuar rrugëtimin e saj profesional mbi një bazë të fortë arsimore në gazetari dhe komunikim...

faqe 2



NGA BESIMI TEK KOMBI: PASHKËT DHE MODELI SHQIPTAR I HARMONISË FETARE

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Bashkëjetesa fetare, themeli i identitetit kombëtar në kremtimin e Pashkëve. Kremtimi i Pashkëve në Shqipëri dhe në hapësirat shqiptare nuk është vetëm një akt fetar i rëndësishëm për besimtarët e krishterë, por një dëshmi e gjallë e një prej vlerave më të rralla dhe më të çmuara të kombit shqiptar...

faqe 7

Pranvera Skana emërohet zyrtarisht zëvendësministre e Mbrojtjes

Pranvera Skana, një profil profesional në shërbim të komunikimit dhe sigurisë

Emërimi i znj. Pranvera Skana në detyrën e zëvendësministres së Mbrojtjes shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e dimensionit të komunikimit strategjik në institucionet e sigurisë në vend. Me një profil të konsoliduar në fushën e medias, diplomacisë dhe akademisë, ajo sjell në këtë detyrë një kombinim të vyer përvoja dhe ekspertize.

E lindur në Rrëshen të Mirditës, Skana ka ndërtuar rrugëtimin e saj profesional mbi një bazë të fortë arsimore në gazetari dhe komunikim, duke përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës. Më tej, ajo ka thelluar njohuritë në arenën ndërkombëtare, përmes specializimeve në Londër, ku ka përfutur bursa për lidhshmëri akademik dhe ka përfunduar studimet master në University of Westminster, si dhe ka kontribuar si kërkuese shkencore në London School of Economics.

Që prej vitit 2014 mban titullin Doktor në Shkencat e Komunikimit, duke u angazhuar paralelisht në trajtimin e temave me rëndësi publike si emigracioni, politika ndërkombëtare, çështjet sociale dhe ndikimi i mediave në shoqëri. Përvoja e saj në diplomaci, veçanërisht gjatë shërbimit në Ambasadën Shqiptare në Londër në vitet 2016–2019, ka qenë një tjetër shtyllë e rëndësishme në karrierën e saj. Ajo ka luajtur një rol aktiv në promovimin e imazhit të Shqipërisë dhe në zhvillimin e diplomacisë publike, duke ndërtuar ura bashkëpunimi me aktorë ndërkombëtarë.

Në detyrën e re në Ministrinë e Mbrojtjes, Pranvera



Skana pritet të kontribuojë në forcimin e komunikimit institucional dhe në rritjen e bashkërendimit ndërmjet strukturave të sigurisë dhe aktorëve të emergjencave civile. Profili i saj shumëdimensional e vendos atë si një element kyç në përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë dhe në modernizimin e qasjes komunikative të institucioneve të mbrojtjes.



Gjeneral brigade Edmond Voci merr detyrën si Komandant i Forcës Ajrore

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, në pjesën ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, u zhvillua ceremonia e marrjes së detyrës së komandantit të ri të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Edmond Voci.

Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, zëvendësministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandantët e forcave, si dhe efektivë nga të gjitha repartet e Forcës Ajrore.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes vlerësoi kontributin dhe drejtimin e deritanishëm të gjeneralmajor Ferdinand Dima, duke theksuar rolin e rëndësishëm të Forcës Ajrore në kuadër të Forcave të Armatosura dhe të angazhimeve të Shqipërisë në NATO.

Ai u shpreh se ndërrimi i komandës përfaqëson vazhdimësinë institucionale dhe besimin tek e ardhmja, ndërsa nënvizoi se transformimi i Forcës Ajrore është pjesë e rrugëtimit të Shqipërisë si një aleat i besueshëm në Aleancë.

Ministri theksoi gjithashtu rëndësinë e investimit në kapitalin njerëzor, përmes përmirësimit të kushteve të shërbimit, rritjes së pagave dhe trajnimit të vazhdueshëm sipas standardeve të NATO-s. Ai evidentoi pjesëmarrjen aktive të Forcës Ajrore në misione dhe stërvitje ndërkombëtare, si dhe objektivat për rritjen e kapaciteteve operationale, përfshirë plotësimin e flotës së helikopterëve.

Më tej, ministri Nufi përmendi rëndësinë strategjike të Bazës Ajrore të Kuçovës si një bazë e NATO-s, e cila rrit rolin e Shqipërisë në sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Ministri i Mbrojtjes shprehu besimin se komandanti i ri, gjeneral brigade Edmond Voci, do të vijojë me përkushtim dhe profesionalizëm misionin e Forcës Ajrore, duke garantuar mbështetjen e plotë të institucionit që ai drejton.

Në fjalën e tij, gjeneral brigade Edmond Voci shprehu vizionin për një Forcë Ajrore moderne, të mirë trajnuar, të disiplinuar dhe të bashkuar, ku çdo individ ndihet i vlerësuar dhe i motivuar për të dhënë më të mirën në shërbim të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, u zhvillua ceremonia simbolike e dorëzimit të detyrës, ku gjeneralmajor Dima i dorëzoi flamurin e forcës shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Kingji, i cili më pas ia dorëzoi atë komandantit të ri, gjeneral brigade Voci.



Gjenerallejtënant Arben Kingji pret homologun italian për forcimin e partneritetit ushtarak

Rritet bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Itali, në kuadër të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim zyrtar me shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura italiane, gjeneral Luciano Portolano. Gjatë këtij takimi dypalësh, u rikonfirmua bashkëpunimi i ngushtë dhe partneriteti i qëndrueshëm ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes. Të dy palët vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera ushtarake dhe rolin e tyre në forcimin e sigurisë rajonale.



Gjenerallejtënant Kingji dhe gjeneral Portolano, shprehën angazhimin e përbashkët për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit strategjik, në funksion të përballimit të sfidave të përbashkëta të sigurisë. Në fokus të diskutimeve ishte gjithashtu përmirësimi i detyrimeve në kuadër të NATO-s, si dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave të armatosura të dy vendeve. Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm në konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në avancimin e bashkëpunimit ushtarak Shqipëri-Itali, në përputhje me standardet dhe objektivat e Aleancës.



Në një kohë kur sfidat e sigurisë janë gjithnjë në ndryshim, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijojnë të mbeten një nga shtyllat kryesore të garantimit të sigurisë kombëtare dhe kontributit në misionet ndërkombëtare. Përballë rritjes së angazhimeve dhe modernizimit të kapaciteteve, sot më shumë se kurrë, Forcat e Armatosura u bëjnë thirrje të rinjve shqiptarë t'i bashkohen radhëve të tyre.

Një rrugë drejt profesionit dhe zhvillimit personal
Të bëhesh pjesë e ushtrisë nuk është vetëm një zgjedhje për të veshur uniformën, por një investim në të ardhmen. Të rinjtë që i bashkohen Forcave të Armatosura përfitojnë arsimim cilësor, trajnim profesional dhe mundësi të shumta zhvillimi brenda dhe jashtë vendit. Përmes Akademisë së Forcave të Armatosura, kandidatët përgatiten në fusha të ndryshme, duke ndërtuar një karrierë të qëndrueshme dhe të respektuar.

Mision, përgjegjësi dhe kontribut real
Shërbimi në Forcat e Armatosura nënkupton përkushtim ndaj atdheut dhe gatishmëri për të kontribuar në çdo situatë. Nga operacionet e kërkim-shpëtimit, menaxhimi i emergjencave civile, deri tek pjesëmarrja në misione ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, ushtarakët shqiptarë janë pjesë aktive e sigurisë globale.

Kërkesa në rritje për profesionistë të rinj
Sipas përfaqësuesve të Forcës Ajrore dhe strukturave të tjera, rritja e numrit të misioneve dhe modernizimi i pajisjeve ka sjellë një nevojë të shtuar për burime njerëzore. Pilotë, teknikë, specialistë të teknologjisë, si dhe profesionistë në fusha të ndryshme janë të mirëpritur për t'u bërë pjesë e këtij institucioni.
Në këtë kuadër, edhe zhvillimet e reja si hapja e ardhshme e shkollës së aviacionit pritet të krijojnë më shumë mundësi për të rinjtë që synojnë një karrierë në ajër, duke e bërë rrugën drejt profesionit të pilotit më të drejtpërdrejtë dhe të aksesueshme.

Përtej një profesioni, një stil jete
Të qenit pjesë e Forcave të Armatosura do të thotë disiplinë, përkushtim dhe sfidë e vazhdueshme. Është një zgjedhje për ata që kërkojnë më shumë nga vetja, që duan të provojnë kufijtë e tyre dhe të kontribuojnë

Forcat e Armatosura

Një mundësi për të rinjtë që kërkojnë sfidë, profesion dhe shërbim ndaj vendit



për diçka më të madhe se vetja.



e Armatosura nuk kërkojnë vetëm forcë fizike, por edhe mendje të hapur, përkushtim dhe dëshirë për të mësuar.
Sepse në fund, kjo nuk është thjesht një karrierë, është një zgjedhje për të ndërtuar veten, për të sfiduar të pamundurën dhe për të shërbyer me dinjitet.

Një mundësi që pret të rinjtë shqiptarë

Nëse dikur rruga drejt ushtrisë shihej si e vështirë dhe e largët, sot ajo është më e hapur dhe më e qartë për çdo të ri që ka vullnet dhe ambicie. Forcat

Komandanti i Forcës Tokësore zhvilloi takime me atashetë ushtarakë nga Turqia dhe Pakistani

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, zhvilloi takime me atashetë ushtarak të Turqisë, kolonel Tolga Kip dhe atashetë ushtarak të Pakistanit, gjeneral brigade Imtiaz Shahzada.
Gjatë takimit me palën turke u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh, me fokus trajnimet e përbashkëta dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira. Ndërsa me palën pakistaneze u hodhën hapat e parë drejt një bashkëpunimi për të ardhmen.
Takimet riafirmuan angazhimin e Forcës Tokësore për rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e partneriteteve ndërkombëtare, duke u mbështetur në bashkëpunim të qëndrueshëm dhe shkëmbim profesional me vendet partnere.



Shqipëria dhe USEUCOM forcojnë partneritetin në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me gjeneral brigade Chris McKinney, zëvendësdirjtor i Drejtorisë për Planifikim, Politika, Strategji dhe Kapacitete në Komandën Amerikane për Evropën (USEUCOM).
Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet më të fundit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe mbi situatën e sigurisë në rajon dhe më gjerë.
Bashkëbiseduesit vlerësuan nivelin e lartë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të USEUCOM-it në rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura, zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta, si dhe kontributin e rëndësishëm të Shqipërisë në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO.
Takimi riafirmoi angazhimin e përbashkët për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në funksion të rritjes së sigurisë dhe stabilitetit rajonal.





KLSM-16 zhvillon vizita studimore në Kosovë dhe në bashkitë Klos e Mat

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), zhvilloi një vizitë studimore në kuadër të programit “Mbi njohjen e institucioneve ndërkombëtare”, në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

Delegacioni, i kryesuar nga komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, realizoi vizita në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës, në selinë e EULEX-it, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë, si dhe në bazën e KFOR-it.

Gjatë takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, grupi u prit nga ministri i Mbrojtjes, z. Ejup Maqedonci dhe stafi i tij. Diskutimet u përqendruan në çështje të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, ndikimin e luftës në Ukrainë dhe përkushtimin e Kosovës për avancimin e reformave në sektorin e mbrojtjes. U theksua rëndësia e garantimit të misionit kushtetues të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe progresi drejt anëtarësimit në NATO dhe integritet në Bashkimin Evropian.

Ministri Maqedonci nënvizoi domosdoshmërinë e thellimit të bashkëpunimit rajonal dhe vizionin evropian të Kosovës, të lidhur ngushtë me partneritetin me vendet fqinje dhe angazhimin për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Në përfundim, ai i cilësoi kursantët si liderë të ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Nga ana e tij, gjeneral brigade Altin Kurti shprehu mirënjohjen për mikpritjen dhe organizimin e takimit.

Në vijim të vizitës, delegacioni u prit në selinë e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), ku u njoh me mandatin dhe rolin e këtij misioni në mbështetje të stabilitetit dhe sigurisë. Përmes prezantimeve nga drejtuesit e misionit, pjesëmarrësit u informuan mbi funksionimin e EULEX-it si instrument i Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian.

Grupi mësimor vizitoi gjithashtu Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, ku u prit nga Ambasadori, SH.T. z. Petrit Malaj. Ai prezantoi rolin dhe misionin e ambasadës, si dhe angazhimin e Shqipërisë në mbështetje të Kosovës në fusha të ndryshme, përfshirë sigurinë dhe mbrojtjen, si dhe proceset integruuese euroatlantike.

Programi vijoi me vizitë në Komandën e KFOR-it në Prishtinë, ku delegacioni u prit nga drejtues të lartë të kësaj strukture. Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me misionin, organizimin dhe angazhimet aktuale të KFOR-it, si dhe me bashkëpunimin e tij me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.



Përgjatë gjithë vizitës, anëtarët e KLSM-16 zhvilluan diskutime dhe shkëmbime profesionale mbi çështje të sigurisë dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, duke vlerësuar mikpritjen dhe angazhimin e institucioneve pritëse.

Në vijim të programit të vizitave studimore, pjesëmarrësit e KLSM-16 zhvilluan vizita edhe në Bashkinë Klos dhe në Bashkinë Mat. Ata u pritën nga Kryetarja e Bashkisë Klos, znj. Valbona Kola dhe Kryetari i Bashkisë Mat, z. Altin Bojni, me të cilët diskutuan mbi rolin e pushtetit vendor në mbrojtjen civile, sigurinë dhe bashkëpunimin me Forcat e Armatosura në rastet e emergjencave civile.

Pjesë e programit ishte edhe vizita në muzeun historik të Matit, ku kursantët u njohën me trashëgiminë kulturore dhe historike të zonës, si një element i rëndësishëm në forcimin e identitetit dhe vlerave kombëtare.

Vizita të tilla studimore kontribuojnë në rritjen e njohurive strategjike dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke përgatitur liderët e ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Stërvitje kompaktuese në Bizë, fokus në aftësitë taktike dhe ndërveprim

Në rajonin stërvitor të Bizës u zhvillua me sukses stërvitja kompaktuese e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL), me pjesëmarrjen edhe të kursantëve të kursit SIB.

Gjatë kësaj stërvitjeje, efektivët u angazhuan në skenarë të ndryshëm taktikë, duke synuar rritjen e aftësive profesionale, koordinimit dhe reagimit në situata operacionale.

Stërvitja kontribuoi ndjeshëm në forcimin e ndërveprimit ndërmjet strukturave, si dhe në rritjen e nivelit të përgatitjes operacionale të trupave në funksion të përmbytjes me sukses të misioneve të Forcave të Armatosura.

Pjesëmarrja e kursantëve të kursit SIB në këtë aktivitet shërbeu gjithashtu si një mundësi praktike për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të fituara gjatë procesit të tyre të trajnimit.





30 vite SHKURSH: Rrugëtim, vlera dhe bashkëpunim ndërkombëtar

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë kremtoi 30-vjetorin e krijimit të saj në një ceremoni të organizuar me pjesëmarrjen e gjerë të ushtarakëve nga të gjitha degët e shoqatës, si dhe të personaliteteve të larta të Forcave të Armatosura.

Në këtë aktivitet morën pjesë dhe nderuan me praninë e tyre, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Enkelejd Joti, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjeneral brigade Razie Mehmeti, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Altin Gjetaj, si dhe shumë ushtarakë të tjerë aktivë dhe në pension.

Pjesëmarrja e delegacioneve nga Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova dëshmoi edhe një herë forcimin e bashkëpunimit rajonal mes ushtarakëve.

Ceremonia nisi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar dhe mbajtjen e një minute heshtje në nderim të ish-ushtarakëve të ndarë nga jeta.

Hapjen e aktivitetit e bëri Sekretari i Përgjithshëm z. Arben Mollaj, në cilësinë e moderatorit, i cili mundësoi edhe shfaqjen e një materiali filmik mbi rrugëtimin 30-vjeçar të shoqatës.

Në vijim u përçoll një mesazh përshëndetës nga z. Zyhdi Kroi. Aktiviteti vijoi me fjalët përshëndetëse të Presidentit të SHKURSH, Hamit Gojani, të gjeneral brigade Razie Mehmeti, si dhe të ish-kryetarit të SHKURSH Thoma Konduri, i cili promovoi librin mbi historikun e SHKURSH.

Më pas u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së trofeve për delegacionet e vendeve partnere pjesëmarrëse në aktivitet. Një moment i veçantë ishte vlerësimi dhe dhënia e titullit për ushtarakun shqiptar që jeton në Mal të Zi, Vojin Dimnaku, i cili u shpall "Ambasador i ushtarakëve shqiptarë në Mal të Zi".

Aktiviteti vijoi me shpërndarjen e certifikatave të mirënjohjes nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve dhe nga Bordi i SHKURSH, për kontribute të spikatura ndër vite.

Në përmbyllje, pjesëmarrësit ndoqën një ekspozitë fotografike të organizuar në holl, nën tingujt e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, duke i dhënë aktivitetit një atmosferë dinjitoze dhe festive.

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë shpreh mirënjohje për të gjithë anëtarësinë e saj, kudo që ndodhen, për përkushtimin dhe kontributin e dhënë ndër vite.





ANJEZA MUSOLLARI, Shefe e Sektorit të Botimeve

Një botë që flet shumë, por nuk ‘mendon’

Nëse do të kishim guximin ta shihnim veten pa filtra, pa dekor dhe pa justifikime, diagnoza që do të dilte mbi gjendjen e sotme të shoqërisë sonë nuk do të ishte aspak e rehatshme. Nuk do të flisnim për mungesë zhvillimi, as për krizë ekonomike apo politike. Do të përballëshim me një realitet më të thellë dhe më të rrezikshëm, deformimin e vetë kuptimit të kulturës. Një gjendje që mund të përmblihet në një shprehje të vetme, kultura e rreme.

Kjo nuk është një akuzë morale e zakonshme dhe as një nostalgji për një të kaluar të idealizuar. Është një konstatim i ftohtë mbi një transformim të heshtur, por të gjithanshëm. Sepse sot nuk kemi më të bëjmë me mungesë kulture. Përkundrazi, jemi të rrethuar nga një tepricë e saj ose më saktë, nga një tepricë e dukjes së saj. Kultura është bërë më e pranishme se kurrë në diskursin publik, në media, në rrjete sociale, në institucione. Por pikërisht kjo prani e tepruar ka zbuluar paradoksin më të madh sa më shumë flitet për kulturën, aq më pak ajo ekziston si përvojë reale.

Në të kaluarën, analfabetizmi ishte një errësirë e qartë. Ai pengonte qasjen në dije, por nuk e falsifikonte atë. Sot, përkundrazi, jetojmë në një dritë artificiale që nuk ndriçon, por verbon. Një dritë që krijon iluzionin e dijes, ndërkohë që e zhdruk vetë procesin e saj. Kjo është arsyeja pse kultura e rreme është më e rrezikshme se injoranca, sepse ajo nuk ndjehet si mungesë, por si përmbushje.

Në këtë realitet të ri, kultura ka pushuar së qeni një akt transformues. Ajo nuk është më një proces i brendshëm, që kërkon kohë, përkushtim dhe përballje me veten. Është shndërruar në një produkt të menjëhershëm, të pakeluar dhe të gatshëm për konsum. Nuk ndërtohet më si identitet, por përdoret si imazh. Dhe kështu, pa e kuptuar, kemi hyrë në një epokë ku **të dukesh ka fituar përfundimisht ndaj të qenit**.

Nga Dija te Duka: Transformimi i Kulturës në Konsum

Ky ndryshim nuk është sipërfaqësor. Ai prek vetë strukturën e individit dhe të shoqërisë. Sepse kur kultura reduktohet në dukje, ajo humbet funksionin e saj etik. Nuk kërkon më përgjegjësi, nuk kërkon më thellësi, nuk kërkon më sakrificë. Ajo bëhet një lojë, një performancë e vazhdueshme ku rëndësi ka vetëm perceptimi i të tjerëve.

Në këtë lojë, imitimi ka marrë një rol qendror. Por nuk bëhet fjalë për imitim klasik, atë të papërpunuar dhe të dallueshëm. Bëhet fjalë për një imitacion të rafinuar, që nuk e mohon të vërtetën, por e riprodhon atë në formë sterile. Një klonim i ideve, i qëndrimeve, i diskurseve, që ruan formën, por humbet përmbajtjen. Dhe pikërisht këtu qëndron rreziku kur forma mbijeton pa përmbajtje, ajo bëhet një mekanizëm bosh që mund të përdoret për çdo qëllim.


Diskursi publik është sot prova më e qartë e këtij fenomeni. Ai është i mbushur me referenca, me citime, me terminologji të sofistikuar. Por në thelb, shpesh mungon ajo që është më e rëndësishmja, mendimi. Debatet zhvillohen, por rrallëherë prodhojnë përballje reale idesh. Fjalët përdoren si mjete për të krijuar iluzionin e thellësisë, jo për ta arritur atë.

Në këtë klimë, lind një figurë e re, **kuazi-intelektuali**. Një individ që ka përvetësuar gjuhën e kulturës, por jo substancën e saj. Ai di të flasë, por jo të mendojë, di të citojë, por jo të kuptojë, di të paraqitet, por jo të përballlet me të vërtetën. Kjo figurë nuk është marginale. Përkundrazi, ajo po bëhet dominante në hapësirën publike.

Kjo është ajo që mund të quhet mediokritet i institucionalizuar. Një sistem që prodhon dhe promovon individë të aftë për t'u përshtatur, por jo për të sfiduar. Një sistem ku sukcesi nuk lidhet me thellësinë e mendimit, por me aftësinë për të menaxhuar perceptimin. Dhe në këtë sistem, kultura nuk është më një mjet emancipimi, por një instrument integrimi.

Shoqëria që Lexon Tituj, Por Jo Mendim

Pasoja më e rëndë e këtij transformimi është humbja e autenticitetit. Njeriu i sotëm po mësohet të jetojë në një realitet të ndërmjetëm, ku gjithçka është e filtruar, e përpunuar dhe



e paraqitur. Një realitet ku përvoja zëvendësohet nga imazhi i saj, dhe ku identiteti ndërtohet mbi bazën e asaj që duket, jo asaj që është.

Kjo gjendje krijon një paradoks të thellë, sa më shumë komunikojmë, aq më pak kuptohemi. Sepse komunikimi është bërë i menjëhershëm, por jo i thellë. Ai kërkon reagim, jo reflektim. Kërkon prezencë, jo përmbajtje. Dhe në këtë ritëm të përshpejtuar, mendimi nuk ka kohë të piqet.

Kultura e rreme ushqehet pikërisht nga kjo mungesë kohe. Ajo ka nevojë për shpejtësi, për spektakël, për konsum të vazhdueshëm. Thellësia është armiku i saj më i madh, sepse thellësia kërkon ndalesë. Dhe ndalesa, në një botë që mat gjithçka me shpejtësi dhe dukje, perceptohet si dështim.

Kështu, shoqëria jonë po shndërrohet në një hapësirë të mbingarkuar me informacion, por të varfër në kuptim. Gjithçka është e dukshme, por asgjë nuk depërton në thelb. Një botë ku maska është bërë normë, dhe ku çdo përpjekje për autenticitet shihet me dyshim.

Diagnoza e Kulturës së Rreme në Shoqërinë Moderne

Arsimi, media, institucionet kulturore të gjitha janë të përfshira në këtë cikël të riprodhimit të dukjes. Jo gjithmonë me qëllim, por shpesh si rezultat i një sistemi që shpërblen sipërfaqen dhe penalizon thellësinë.

Kjo është arsyeja pse kultura e rreme nuk vjen si një sulm i jashtëm. Ajo është një mutacion i brendshëm. Një proces i

ngadaltë, por i vazhdueshëm, që e transformon kulturën nga një përvojë në një dekor.

Dhe ndoshta rreziku më i madh qëndron këtu, në normalizimin e këtij deformimi. Sepse kur një shoqëri mësohet të jetojë me imitimin e kulturës, ajo humbet aftësinë për ta dalluar atë nga e vërteta. Dhe në momentin që dallimi zhduket, zhduket edhe vetë nevoja për të kërkuar të vërtetën.

Një shoqëri e tillë nuk është më në krizë. Ajo është në një gjendje më të rëndë në ‘vetëkënaqësi’. Ajo nuk ndjen më mungesën, sepse e ka mbushur atë me simulime.

Por pikërisht në këtë pikë lind edhe mundësia e vetme për ndryshim, ndërgjegjësimi. Sepse çdo transformim i vërtetë fillon me pranimin e problemit.

Duhet të rikthejmë idenë se kultura nuk është një dekor, por një proces. Nuk është një status, por një përpjekje. Nuk është një mjet për t'u dukur, por një mënyrë për të qenë.

Kjo kërkon kohë. Kërkon përballje me veten. Kërkon refuzimin e rrugëve të lehta. Dhe mbi të gjitha, kërkon guximin për të qenë autentik në një botë që shpërblen imitim.

Kultura e vërtetë nuk është ajo që shfaqet më shumë. Është ajo që mbetet më gjatë. Dhe një shoqëri që dëshiron të mbijetojë jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht, duhet ta kuptojë këtë para se të jetë vonë.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Bashkëjetesa fetare, themeli i identitetit kombëtar në kremtimin e Pashkëve

Kremtimi i Pashkëve në Shqipëri dhe në hapësirat shqiptare nuk është vetëm një akt fetar i rëndësishëm për besimtarët e krishterë, por një dëshmi e gjallë e një prej vlerave më të rralla dhe më të çmuara të kombit shqiptar, bashkëjetesa fetare. Në një botë ku tensionet mbi baza fetare vazhdojnë të prodhojnë konflikte dhe ndarje, modeli shqiptar paraqet një realitet të veçantë, ku përkatësia fetare nuk ka qenë kurrë pengesë për unitetin kombëtar.

Pashkët, si festa e ringjalljes dhe e shpresës, marrin një dimension edhe më të gjerë në kontekstin shqiptar. Ato shndërrohen në një simbol të harmonisë shoqërore, ku besime të ndryshme bashkëjetojnë në respekt të ndërsjellë dhe në solidaritet të plotë. Ky fenomen nuk është rastësi, por produkt i një historie të gjatë, i një kulture të ndërtuar mbi tolerancën dhe i një vetëdijeje kombëtare që ka ditur të vendosë kombin mbi ndasitë.

Pashkët në kontekstin shqiptar, përtej dimensionit fetar

Në traditën shqiptare, Pashkët kremtohen nga komunitetet ortodokse dhe katolike me rite të veçanta, por atmosfera festive kapërcen kufijtë e besimit. Në shumë familje shqiptare, pavarësisht përkatësisë fetare, vizitat, urimet dhe ndarja e gëzimit janë të zakonshme. Kjo tregon se festa nuk perceptohet vetëm si një ngjarje fetare, por si një moment i përbashkët shoqëror.

Ngjyrosja e vezëve, përgatitja e ushqimeve tradicionale dhe pjesëmarrja në rituale janë elementë që shpesh ndahen edhe me fqinjë apo miq të besimeve të tjera. Në këtë mënyrë, Pashkët bëhen një urë lidhëse mes komuniteteve dhe një rast për të forcuar marrëdhëniet njerëzore.

Ky dimension social i festës është një tregues i qartë se identiteti shqiptar është ndërtuar mbi një koncept përfshirës, ku dallimet nuk përjashtojnë, por pasurojnë.

Bashkëjetesa fetare si vlerë kombëtare

Shqiptarët historikisht i përkasin tri besimeve kryesore: myslimanë, katolikë dhe ortodoksë. Megjithatë, ndryshe nga shumë vende të tjera, këto dallime nuk kanë prodhuar përçarje të thella. Përkundrazi, ato kanë bashkëjetuar në një ekuilibër të admirueshëm.

Kremtimi i Pashkëve është një shembull konkret i kësaj harmonie. Në shumë zona të vendit, qytetarë të besimit mysliman marrin pjesë në urimet për Pashkë, ashtu siç të krishterët marrin pjesë në festat e Bajramit. Ky shkëmbim i ndërsjellë është kthyer në një normë sociale, e cila forcon kohezionin kombëtar.

Bashkëjetesa fetare në Shqipëri nuk është thjesht tolerancë pasive, por një ndërveprim aktiv dhe i sinqertë. Ajo bazohet në respektin për tjetrin dhe në një ndjenjë të fortë përkatësie kombëtare që tejkalon çdo ndarje tjetër.

Roli i historisë në ndërtimin e harmonisë fetare

Historia e shqiptarëve ka luajtur një rol kyç në formësimin e këtij modeli unik. Në periudha të ndryshme, shqiptarët janë përballur me sfida të mëdha, ku mbijetesa e kombit ka qenë në rrezik. Në këto momente, përkatësia fetare ka kaluar në plan të dytë, ndërsa uniteti kombëtar është vendosur në qendër.

Rilindja Kombëtare është një shembull i qartë, ku

NGA BESIMI TEK KOMBI: Pashkët dhe Modeli Shqiptar i Harmonisë Fetare



figura nga besime të ndryshme punuan së bashku për çështjen kombëtare. Kjo frymë vazhdoi edhe në periudhat e mëvonshme, duke krijuar një traditë të fortë bashkëpunimi ndërfetar.

Në këtë kontekst, kremtimi i Pashkëve nuk është vetëm një akt besimi, por edhe një reflektim i kësaj historie të përbashkët. Ai përfaqëson vazhdimësinë e një tradite që ka mbijetuar ndër shekuj.

Forcat e Armatosura dhe reflektimi i vlerave kombëtare

Gazeta “Ushtria” ka një rol të veçantë në pasqyrimin e vlerave që mbajnë të bashkuar kombin. Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë një mikrokozmos i shoqërisë shqiptare, ku individë nga besime të ndryshme shërbejnë së bashku për një qëllim të përbashkët: mbrojtjen e atdheut.

Brenda strukturave ushtarake, bashkëjetesa fetare nuk është vetëm një realitet, por një domosdoshmëri funksionale. Ushtarët dhe oficerët ndajnë të njëjtat sfida, të njëjtat përgjegjësi dhe të njëjtin ideal, pavarësisht besimit të tyre.

Kremtimi i festave fetare në mjediset ushtarake shpesh bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke respektuar diversitetin dhe duke forcuar ndjenjën e unitetit. Në këtë kuptim, ushtria shqiptare përfaqëson një model

Në periudha të ndryshme, shqiptarët janë përballur me sfida të mëdha, ku mbijetesa e kombit ka qenë në rrezik. Në këto momente, përkatësia fetare ka kaluar në plan të dytë, ndërsa uniteti kombëtar është vendosur në qendër.

të suksesshëm të integritetit dhe bashkëjetesës.

Sfida dhe perspektiva në një botë globale

Megjithëse modeli shqiptar i bashkëjetesës fetare është i admirueshëm, ai nuk është i imunizuar ndaj sfidave të kohës moderne. Globalizimi, ndikimet kulturore dhe tensionet ndërkombëtare mund të ndikojnë edhe në shoqërinë shqiptare.

Megjithatë, pikërisht në këto rrethana, ruajtja dhe promovimi i kësaj vlere bëhet edhe më i rëndësishëm. Pashkët, si një festë e shpresës dhe e ringjalljes, ofrojnë një mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e unitetit dhe për të forcuar lidhjet mes njerëzve.

Institucionet shtetërore, komunitetet fetare dhe shoqëria civile kanë një rol të përbashkët në ruajtjen e kësaj harmonie. Edukimi, dialogu dhe respekti i ndërsjellë janë elementë kyç për të siguruar vazhdimësinë e këtij modeli.

Pashkët si simbol i bashkimit kombëtar

Në thelb, Pashkët në Shqipëri janë më shumë sesa një festë fetare. Ato janë një simbol i bashkimit, i tolerancës dhe i respektit të ndërsjellë. Ato tregojnë se është e mundur të jetosh në harmoni, edhe kur dallimet ekzistojnë.

Ky mesazh është veçanërisht i rëndësishëm në një kohë kur bota përballlet me ndarje dhe konflikte. Shqipëria, përmes modelit të saj, ofron një shembull të vlefshëm për komunitetin ndërkombëtar.

Kremtimi i Pashkëve në Shqipëri është një dëshmi e gjallë e një prej pasurive më të mëdha të kombit, bashkëjetesa fetare. Kjo vlerë nuk është vetëm një trashëgimi historike, por një aset strategjik për të ardhmen.

Për gazetën “Ushtria”, theksimi i kësaj vlere është një kontribut i rëndësishëm në forcimin e identitetit kombëtar dhe në promovimin e unitetit. Në një botë të trazuar, modeli shqiptar mbetet një dritë shprese, një dëshmi se harmonia është e mundur.

Në këtë frymë, Pashkët nuk janë vetëm një festë e besimit, por një festë e vetë shqiptarisë.

“LAHUTA E MALCÍS”: EPOSI QË NDËRTOI KUJTESËN KOMBËTARE

Më 8 prill 1937, shënohet një moment i veçantë në historinë e kulturës shqiptare, botimi i plotë i ‘Lahuta e Malcís’, kryeveprës monumentale të Gjergj Fishtës. Kjo poemë epike, që përbën një nga kulmet e letërsisë shqipe, nuk është vetëm një krijim artistik, por një dëshmi e gjallë e historisë, identitetit dhe shpirtit të një kombi.

Një vepër e lindur nga tri dekada përkushtimi

“Lahuta e Malcís” është fryt i një pune të gjatë rreth 30-vjeçare, gjatë së cilës Fishta ndërtoi me durim dhe mjeshtëri një univers poetik që përfshin mbi 15 mijë vargje. Në këtë vepër, ai bashkon dokumentimin historik me artin e fjalës, duke krijuar një narrativë epike që rrallë gjendet në letërsinë europiane të kohës.

Fishta nuk ishte vetëm poet, por edhe njohës i thellë i traditës gojore shqiptare. Ai u mbështet në këngët popullore, rrëfimet historike dhe kujtesën kolektive për të ndërtuar një vepër që tingëllon autentike dhe e gjallë edhe sot.

Historia e një kombi në vargje

Në thelb, “Lahuta e Malcís” është një kronikë poetike e përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur trojet dhe identitetin e tyre. Vepra përshkruan përleshjet kufitare në Hot dhe Grudë, duke sjellë në qendër qëndresën ndaj forcave malazeze.

Kyç i ndërgjegjësimit kombëtar dhe organizimit politik të shqiptarëve. Përmes vargjeve epike, Fishta e ngre këtë ngjarje në nivelin e mitit kombëtar, duke i dhënë asaj dimensione heroike dhe simbolike.

Po ashtu, trajtohen zhvillimet që pasuan Kongresi i Berlinit, ku fuqitë e mëdha vendosën fatin e territoreve shqiptare pa pjesëmarrjen e shqiptarëve. Në këtë kontekst, poeti shpreh zhgënjimin, por edhe vendosmërinë për të mos u nënshtruar.

Rrëfimi vazhdon me periudhën e Revolucionit Xhonturk dhe përfundon me një nga momentet më kulmore të historisë sonë: Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Kështu, poema përshkon një hark të gjerë kohor, duke e bërë atë një pasqyrë të plotë të historisë moderne shqiptare.

Arkivë poetike e kujtesës kolektive


Përtej dimensionit artistik, “Lahuta e Malcís” shërben si një arkivë e rrallë e kujtesës kolektive shqiptare. Në mungesë të dokumenteve të shumta historike të shkruara, vepra e Fishtës merr rolin e një dëshmitari të kohës, duke ruajtur ngjarje, figura dhe emocione që përndryshe mund të ishin harruar.

Fishta arrin të ndërthurë historinë me mitin, realitetin me simbolikën, duke krijuar një narrativë që jo vetëm informon, por edhe frymëzon. Ai nuk kufizohet në përshkrimin e ngjarjeve, por depërton në shpirtin e kombit, duke nxjerrë në pah vlerat e besës, nderit dhe sakrificës.

Gjuha dhe stili, autenticiteti i epopesë

Një nga elementët më të spikatur të “Lahutës së Malcís” është gjuha. Fishta përdor dialektin gegë me një mjeshtëri të rrallë, duke e ngritur atë në nivelin e një gjuhe letrare të fuqishme dhe ekspresive.

Stili i tij karakterizohet nga ritmi epik, figuracioni i



pasur dhe përdorimi i elementeve të folklorit. Metaforat, krahasimet dhe hiperbolat krijojnë një botë të gjallë dhe dinamike, ku lexuesi përfshihet emocionalisht në rrëfim.

Në këtë mënyrë, Fishta jo vetëm që ruan autenticitetin

e traditës shqiptare, por edhe e pasuron atë, duke e bërë pjesë të letërsisë së kultivuar.

Ndikimi në identitetin kulturor shqiptar

“Lahuta e Malcís” ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në formësimin e identitetit kulturor dhe kombëtar shqiptar. Ajo ka ndihmuar në krijimin e një vetëdijeje historike dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë.

Për breza të tërë, kjo vepër ka qenë një burim frymëzimi dhe krenarie. Ajo ka ndikuar jo vetëm në letërsi, por edhe në mendimin politik dhe shoqëror, duke kontribuar në ndërtimin e një narrative kombëtare të përbashkët.


Vlera e saj sot

Edhe sot, “Lahuta e Malcís” mbetet një nga veprat më të rëndësishme të kulturës shqiptare. Ajo studiohet në shkolla dhe universitete, analizohet nga studiues dhe lexohet nga dashamirës të letërsisë.

Në një kohë globalizimi, ku identitetet kombëtare shpesh sfidohen, kjo vepër rikujton rrënjët dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar shoqëria shqiptare. Ajo mbetet një pikë referimi për të kuptuar të kaluarën dhe për të reflektuar mbi të ardhmen.

Botimi i plotë i “Lahutës së Malcís”, më 8 prill 1937, nuk ishte thjesht një ngjarje letrare, por një moment historik për kulturën shqiptare. Përmes kësaj vepre, Gjergj Fishta arriti të krijojë një monument të pavdekshëm të fjalës shqipe.

“Lahuta e Malcís” është më shumë se një poemë, ajo është zëri i një kombi, jehona e historisë së tij dhe dëshmia e gjallë e shpirtit shqiptar. Në faqet e saj, e kaluara dhe arti bashkohen për të ndërtuar një identitet që vazhdon të jetojë dhe të frymëzojë.



Mëngjesi i 7 prillit 1939 shënon një nga ditët më të errëta në historinë e Shqipërisë, por njëkohësisht edhe një nga momentet më të ndritura të qëndresës dhe sakrificës kombëtare.

Në këtë ditë, kur Italia fashiste ndërmori pushtimin e Shqipërisë, një emër u skalit përgjithmonë në kujtesën e kombit: Mujo Ulqinaku. Ai u bë simbol i guximit, i nderit ushtarak dhe i dashurisë së pakufishme për atdheun.

Jeta dhe formimi i një patrioti

Mujo Ulqinaku lindi në vitin 1896 në qytetin e Ulqinit, një trevë me tradita të forta patriotike. Që në moshë të re, ai u lidh me detin dhe jetën ushtarake, duke zgjedhur të shërbente në marinën shqiptare. Si nënoficer, ai u dallua për disiplinë, vendosmëri dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie ndaj detyrës.

Në një kohë kur Shqipëria ishte ende një shtet i ri dhe i brishtë, figura të tilla si Ulqinaku përbënin shtyllat mbi të cilat mbështetej mbrojtja dhe sovraniteti i vendit. Ai nuk ishte vetëm një ushtarak, por një njeri i përkushtuar ndaj idealit të lirisë dhe pavarësisë.

7 Prilli 1939 – Dita e provës së madhe

Ngjarjet e Pushtimi italian i Shqipërisë shënuan një kthesë dramatike për vendin. Forcat italiane, të pajisura me mjete moderne dhe të shumta në numër, zbarkuan në disa porte shqiptare, përfshirë edhe Durrësin, porta kryesore hyrëse e vendit.

Në këtë moment kritik, Mujo Ulqinaku ndodhej në vijën e parë të mbrojtjes. Pa hezitim, ai organizoi qëndresën në portin e Durrësit, duke marrë drejtimin e një grupi të vogël ushtarësh shqiptarë. Përballë një armiku shumë më të fuqishëm, ai nuk u tërhoq, por vendosi të luftonte deri në fund.

Qëndresa heroike në Durrës

Në orët e para të zbarkimit, Ulqinaku u vendos në një pozicion strategjik dhe filloi të qëllonte me mitraloz kundër trupave italiane që avanconin nga anijet drejt bregut. Veprimet e tij krijuan konfuzion dhe humbje në radhët e pushtuesve, duke vonuar përparimin e tyre.

Megjithëse i vetëdijshëm për pabarazinë e forcave, ai vazhdoi luftën me vendosmëri të jashtëzakonshme. Qëndresa e tij nuk ishte thjesht një akt ushtarak, por një mesazh i qartë: Shqipëria nuk dorëzohej pa luftë.

Në kulmin e përballjes, Mujo Ulqinaku ra heroikisht në krye të detyrës, duke u bërë një nga dëshmorët e parë të asaj dite tragjike. Rënia e tij nuk ishte humbje, por një akt sublim që frymëzoi breza të tërë shqiptarësh.

Simbol i patriotizmit dhe frymëzimit kombëtar

Figura e Mujo Ulqinakut u kthye menjëherë në simbol të rezistencës kundër pushtimit. Ai përfaqësonte atë që çdo ushtar dhe qytetar shqiptar duhet të ishte në momentet më të vështira: i guximshëm, i vendosur dhe i gatshëm për sakrificë.

Në historinë e ushtrisë shqiptare, emri i tij qëndron krah për krah me figurat më të ndritura të patriotizmit. Ai nuk luftoi për lavdi personale, por për nderin dhe lirinë e vendit të tij.

Trashëgimia në Forcat e Armatosura dhe shoqëri

Sot, Mujo Ulqinaku kujtohet me nderime të larta nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe nga i gjithë populli shqiptar. Emri i tij është përjetësuar në institucione, rrugë dhe memoriale, duke shërbyer si kujtesë e përhershme e sakrificës së tij.



MUJO ULQINAKU, SIMBOL I QËNDRESËS DHE NDERIT KOMBËTAR

Për ushtarakët shqiptarë, ai mbetet një model i përkushtimit ndaj detyrës dhe betimit ushtarak. Në çdo stërvitje, në çdo mision dhe në çdo angazhim, fryma e tij është një udhërrëfyes për të mbrojtur vendin me dinjitet dhe profesion-alizëm.

Historia e Mujo Ulqinakut nuk është vetëm një kujtim i së kaluarës, por një thirrje për të tashmen dhe të ardhmen. Brezat e rinj duhet të mësojnë nga sakrifika e tij se liria dhe pavarësia nuk janë të dhëna përgjithmonë, por kërkojnë përkushtim dhe përgjegjësi.

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, vlerat që ai përfaqëson, atdhedashuria, guximi dhe ndershmëria mbeten

themelore për ndërtimin e një shoqërie të fortë dhe të drejtë.

Mujo Ulqinaku është më shumë se një emër në histori, ai është një simbol i gjallë i shpirtit shqiptar që nuk dorëzohet përballë sfidave. Rënia e tij, më 7 prill 1939, është një kujtesë e dhimbshme, por edhe një burim krenarie kombëtare.

